



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prudato Received/Delivety	15 - 12 2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot no	Shtojta Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBICK	7510/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1366/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi Anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1366/2023 të datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër Nr.01116/01-0077954/23 të datës 20.10.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunës e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike *“pezullim parandalues”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1366/2023 e datës 01.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.01116/01-0077954/23 i datës 20.10.2023 për Pezullim Parandalues të ankuesit

A r s y e t i m

Ndaj Ankuesit i punësuar në pozitën e punës *„Gjeodet”* në Drejtorin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 20.10.2023 Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.01116/01-0077954/23 përmes të cilit ankuesin e ka pezulluar sipas detyrës zyrtare, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata, ndërsa gjatë kohës së pezullimit i njëjti do të kompensohet me 50% të pagës.

Ankuesi kundër këtij Vendimi, më datë 01.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6802/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin

ankimor se Vendimi me numër Nr.01116/01-0077954/23 të datës 20.10.2023 të Menaxherit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sepse është i pa drejtë dhe i pa bazuar në ligj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 09.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli më datë 12.12.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar me numër protokoll Nr.prot.1366/2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6802/2023 të parashtruar më datë 01.11.2023 nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.01116/01-0077954/23 i datës 20.10.2023 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër nr.02-02/68-2/22 të datës 07.02.2022 të Komisionit Disiplinor në Komunës e Mitrovicës së Jugut; Kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuesit e datës 09.11.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1366/2023 të datës 12.12.2023; Akt Emërimit me numër protokoll Nr.01-112-21098 të datës 14.08.2013; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 21.09.20212; Fletë dorëzimit të datës 23.10.2023; Njoftimin për zhvillimin e procedurës penale me numër P.nr.43/2023 të datës 06.10.2023; Fletë dorëzimit të datës 08.02.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01116/01-0077954 të datës 20.10.2023, për pezullimin parandalues të ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 69 të Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Me dispozitat e nenit 68 dhe 69 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit me numër Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik është përcaktuar që: „ 1.Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil”, si dhe nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 „1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij” si dhe nenin 71 „ 1. Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas këtij ligji, nëpunësja/i civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës. 2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësja/i civil transferohet në një pozitë tjetër të nivelit profesional. Ndërsa, për nëpunësen/ine nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, nëpunësja/i kthehet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 3. Nëpunësja/i civil pezualluar sipas nenit 69, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 dhe 1.10 që bëhet në pajtim me planifikimin e institucionit, pas përfundimit të pezullimit, kthehet në pozitën e njëjtë apo pozitë ekuivalente. 4. Në rastin e pezullimit për një afat deri në tre (3) muaj, pozita e mëparshme e punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit. Ndërsa në rastet e pezullimit si në nën-paragrafit 1.1. të nenit 70 të këtij ligji, vendi i punës nuk plotësohet deri në një (1) vit. 5. Periudha e pezullimit, në rastet e përcaktuara në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.1., 1.3, 1.9., 1.10. dhe 1.11. të nenit 69 dhe paragrafin 1, nën-paragrafin 1.1. të nenit 70 të këtij ligji, llogaritet si përvojë pune në shërbim civil. 6. Periudha e pezullimit, në rastet e përcaktuara në

paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5.,1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji do të llogaritet si përvojë pune në shërbimin civil, në rast se nëpunësja/i civil shpallet e/i pafajshëm me vendim të formës së prerë, apo në rast se procedura penale përfundon për shkaqe të tjera. 7. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.10. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civil përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, për një periudhë pezullimi deri në gjashtë (6) muaj. 8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5.,1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit. 9. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunëses/it civil që ka qenë e pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së saj/tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë.

Kolegji i Këshillit gjate administrimit te shkresave te lendes ka gjetur se Gjykata Themelore e Mitrovicës -Departamenti i Krimeve të Rënda përmes shkresës zyrtare konkretisht Njoftimit të datës 06.10.2023 ka njoftuar Komunën e Mitrovicës së Jugut përkatësisht Zyrën e Kryetarit dhe Njësinë e Menaxhimit të Personelit lidhur me zhvillimin e procedurës penale ndaj ankuesit konkretisht ka njoftuar që „Ndaj *në Gjykatën Themelore të Mitrovicës është duke u zhvilluar procedura penale me numër P.nr.43/2023, për veprën penale: Përdorimi i paautorizuar i pasurisë nga neni 420, paragrafi 1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.75/2022, të datës 08.02.2023*”.

Andaj, duke marr parasysh këtë fakt, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vendosur për refuzimin e ankesës së ankuesit pasi që ka konstatuar që Vendimi me numër protokolli 01116/01-0077954 të datës 20.10.2023 i Njësisë se Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut është nxjerrë në pajtim me dispozitat e legjislacionit të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik që kanë të bëjnë me pezullimin parandalues të nëpunësve civilë. Organi i punësimit përkatësisht, Komuna e Mitrovicës së Jugut është e obliguar që të zbatojë dispozitat e nenit 69 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik për të gjithë nëpunësit civil të punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për të cilët janë përmbushur kushtet për pezullimin parandalues.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se sa i përket veprës së pretenduar penale ndaj tij gjegjësisht për te njëjtat veprime i është shqiptuar masë disiplinore nga Komisioni Disiplinor i Komunës së Mitrovicës së Jugut me datë 07.02.2022 përmes Vendimit me numër Nr.01-116/01-0003833/22 me te cilin ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkeljet e rregullave të punës, duke i shqiptuar masën disiplinore „Ndalim prej 20% të pagës për periudhën prej dy (2) muaj rresht” sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Kolegji i Këshillit konstaton se ne baze te shkresave te lendes ankuesi nuk e ka atakuar asnjëherë me ankesë Vendimin me numër Nr.01-116/01-0003833/22 të datës 07.02.2022 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Mitrovicë, ndërsa për sa i përket Vendimit me numër Nr.01-116/01-0077954 të datës 20.10.2023 lidhur me pezullimin sipas detyrës zyrtare te ankuesit, Kolegji i Këshillit konstaton se ne rastin konkret është krijuar rrethanë e re juridike gjegjësisht Vendimi me numër Nr.01-116/01-0077954 i datës 20.10.2023 është nxjerrë pas njoftimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës -Departamenti i Krimeve të Rënda se ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedura penale me numër P.nr.43/2023, për veprën penale: Përdorimi i paautorizuar i pasurisë nga neni 420, paragrafi 1 KPRK-së, sipas



aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.75/2022, të datës 08.02.2023", andaj Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1366/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Njesisë për Burime Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së